



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr.158, datë 11.09.2019

PËR

SKUALIFIKIMIN DHE PËRJASHTIMIN E KANDIDATIT Z{...}. NGA PROCEDURA E EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 11.09.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjëndjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatin z. {...}, përgatitur nga relatori z. Dritan Hallunaj, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e tij,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimet nr.108, 109, dhe 110 datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :

1. Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative (108), civile (109) dhe penale (110).

Çdo jurist, që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara ne nenin 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, 2 dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi të hapur publike dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar më poshtë.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për t’u emëruar ne Gjykatën e Lartë, sipas nenit 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, janë :

- a) të ketë vjetërsi në profesion, prej 15 vjetësh, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës;
- b) të mbajë gradë shkencore në drejtësi;
- c) të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara më sipër, duhet të plotësojë edhe kriteret, sipas nenit 48, pika 3, shkronja “c” dhe pika 5, si dhe nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si mëposhtë :

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë shtetas shqiptar;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë;
- ç) të mos jetë i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- d) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;
- dh) të mos ketë qenë dhe të mos jetë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete,
- e) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas ligjit.

Plotësimi i kushteve dhe kriterëve të mësipërme do të verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Kandidati që përmbush kushtet dhe kriteret e mësipërme, do të vlerësohet, pikëzohet dhe renditet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, “Për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”.

Në momentin e aplikimit **kandidati duhet të paraqesë këto dokumente :**

- a. Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë, sipas kërkesave të shpallura;
- b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopje të kartës së identitetit;

d) Dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërtetohet përmbushja e kushteve dhe kritereve të përcaktuara më lart.

2. **Brenda afatit** dyjavor nga nga dita e publikimit të vendimeve si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **për tre pozicionet e lira** të shpalluara përmes tre vendimeve si më lart, **ka aplikuar për të marrë pjesë edhe kandidati z. {...}**.

3. **Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019**, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :**

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, si më poshtë:

...;

3. Për z. {...}relator z.Dritan Hallunaj;

...”.

4. **Më datë 26.07.2019**, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, **kandidati, z. {...}**, në rrugë elektronike, **është njoftuar : - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit**, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati është njoftuar edhe për detyrimin për **plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit** ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit tre ditor, kandidati, z. {...}, **ka depozituar rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik**, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, **kandidati nuk ka parashtruar asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

6. **Më datë 29.07.2019**, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion ishte i mangët apo jo konform ligjit (origjinal

ose i njësuar me origjinalin), **kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, është njoftuar për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit**, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

7. **Po më datë 29.07.2019**, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit, z. {...}, në rrugë elektronike, **i janë dërguar formularët dhe autorizimet përkatëse** (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesë ditor, kandidati, z. {...}, ka depozituar rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, **me përjashtim** të dokumentit që provonte që ky kandidat të **mbante gradë shkencore në drejtësi**, kjo sipas nenit 136, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 48, pikat 3/c, nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kriterëve këto të shpallura edhe në vendimet nr.108, 109, dhe 110 datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Brenda afatit të caktuar, kandidati, z. {...}, **paraqiti shpjegimet e tij**.

10. Pas marrjes së shpjegimeve nga kandidati, z. {...}, duke vlerësuar të plota procedurën e verifikimit të ndjekur deri në këtë moment dhe, në veçanti, verifikimet në lidhje me kushtin e kandidimit **“të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”**, mbi konsideratën se në rastin konkret verifikohet rrethanë që ishte e aftë për të passjellë skualifikimin e kandidatit nga procedura konkurruese publike, **relatori i çështjes ia parashtrori rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës**.

11. Në Mbledhjen e **datës 09.09.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës**, duke konsideruar të plota procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi për z. {...}, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, **vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatit për mosplotësimin e këtij kushti kandidimi ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit**.

II. GJETJA E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, vlerëson se gjetja e procedurës së verifikimit është një rrethanë faktike përmes të cilës vërtetohet që kandidati, z. {...}, nuk përmbush njërin prej kushteve dhe kriterëve të kandidimit, pikërisht atë **“të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”**, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Gjetja e procedurës së verifikimit konfirmohet nga mungesa e diplomës që vërteton fitimin e gradës në drejtësi nga vetë kandidati, në shpjegimet e tij.

3. Sipas përcaktimit ligjor të nenit 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kandidati për tu emëruar në Gjykatën e Lartë duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme :

a) të ketë vjetërsi në profesion, prej 15 vjetësh, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës;

b) të mbajë gradë shkencore në drejtësi;

c) të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

4. Pikërisht për sa më lart, konstatohet se kandidati z. {...}, nuk disponon dokument që të provojë **“mbajtjen e gradës shkencore në drejtësi”**, të përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

5. Po ashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të plota procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi për z. {...}.

III. PRETENDIMET E KANDIDATIT DHE VLERËSIMI I TYRE

1. Pas marrjes së njoftimit të dërguar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr.3687/4 datë 02.09.2019, **kandidati z. {...}, ka parashtruar :**

“Unë kandidati për në Gjykatë të Lartë Tiranë, me profesion avokat, me nr. license {...}, dhe v{...}, referuar Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me njoftimin për gjetjen në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit tim për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, në lidhje me kushtin e kandidimit të mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi, përcaktuar në nenin 136, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në një nga kushtet ka qenë dhe mbajtja e gradës shkencore, ku pavarësisht kësaj jam njoftuar më datë 29.07.2019 për mangësitë e dokumentacionit shoqërues që vërtetonte dhe përmbajtjen e këtij kushti të mbajtjes “gradë shkencore në drejtësi”, theksoj se pas dy ditëve të njoftimit, unë kam dorëzuar pranë zyrës së protokollit (regjistrimin e protokollit) zarfin me diplomat përkatëse të noterizuara nga origjinali, krahas diplomës së kursit të plotë të Fakultetit të Drejtësisë për vitin 1995- janar 2003, e shoqëruar edhe me listën e notave, ku dhe në 2004 u pajisa me licensën e avokatit që e ushtroj deri sot.

Duhet të informoj Këshillin e Lartë Gjyqësor Tiranë, unë personalisht edhe pse nuk e kisha detyrim apo kusht, krahas Fakultetit Juridik me kurs të plotë 5 vjeçar, u detyrova që për të rritur nivelin akademiko-shkencor, në fushën akademiko-juridike-shkencore ndoqa kursin 2

vjeçar të Akademisë Profesionale të Biznesit, për vitet 2012-2013 dhe 2013-2014, në programin e studimit “Master i Shkencave” në të drejtën civile dhe tregtare, ku më datë 01.07.2014 kam mbrojtur diplomën dhe jam vlerësuar me notën 10.

Gjatë dy viteve kam marrë shumën totale të krediteve 120 pikë, me një mesatare mesatare të ponderuar 9.22 (nëntë pikë njëzet e dy). Mbrojtja e diplomës më datë 01.07.2014 dhe data e lëshimit të diplomës 19.12.2014, numri i diplomës universitare të përfunduar më parë {...}, datë 20.01.2003.

Përsa i përket interpretimit të gradës shkencore për diplomën master shkencor në të drejtën civile dhe tregtare, theksoj se referuar ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

“Pranimin në programin e ciklit të tretë të studentëve:

1. Pranimi në programin e ciklit të tretë të studentëve është i mundur për kandidatët që kanë fituar “Master Shkencor” dhe plotësojnë kriteret e pranimit.
2. Kriter pranimi për një program studimi të ciklit të tretë është njohja e kandidatit e një prej 5 gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare.
3. Lista e të diplomuara në programet e ciklit të tretë përcillet nga institucionet e arsimit të lartë në ministrinë përgjegjëse, për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.”

Në këto kushte po ju vë në dispozicion edhe pse i kam dorëzuar një kopje të diplomave master shkencor për të Drejtën Civile dhe Tregtare, të noteruar, krahas diplomës për juridik të Universitetit të Tiranës.

Shpresoj që Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLGJ) Tiranë do të verifikojë me përgjegjshmëri kriterin e gradës shkencore, bazuar edhe në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, nëpërmjet diplomës së Masterit Shkencor me kurs 2 vjeçar për të Drejtën Civile dhe Tregtare, pranë Akademisë Profesionale të Biznesit”.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, vlerëson se gjetja e procedurës së verifikimit është një rrethanë faktike përmes të cilës vërtetohet që kandidati, z. {...}, nuk përmbush njërin prej kushteve dhe kriterëve të kandidimit, pikërisht atë **“të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”**, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Gjetja e procedurës së verifikimit konfirmohet nga mungesa e diplomës që vërteton fitimin e gradës në drejtësi nga vetë kandidati, në shpjegimet e tij.

4. **Është i bazuar pretendimi i kandidatit, z. {...}, se: “Pranimi në programin e ciklit të tretë të studentëve është i mundur për kandidatët që kanë fituar “Master Shkencor” dhe plotësojnë kriteret e pranimit”,** por kjo nuk provon faktin që kandidati të këtë kryer studimet e doktoratës dhe të këtë fituar “gradë shkencore”, sepse programet e studimeve të doktoratës janë programe të studimeve të ciklit të tretë, ndërsa programet e studimeve “Master i shkencave” janë studime të ciklit të dytë, kjo referuar Ligjit nr.9741, datë 21.05.2007, (i ndryshuar me ligjin 80/2015) “Për arsimin e lartë”. Pikërisht për këtë arsye kandidati z. {...}, është pajisur me diplomën përkatëse, “Master Shkencor”, dhe nuk disponon dokument që të provojë **“mbajtjen e gradës shkencore në drejtësi”**, të përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

5. **Sipas përcaktimit ligjor të nenit 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kandidati për tu emëruar në Gjykatën e Lartë duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme :**

b) të këtë vjetërsi në profesion, prej 15 vjetësh, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës;

b) **të mbajë gradë shkencore në drejtësi;**

c) të mos këtë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

6. Nga aktet dhe nga vetëdeklarimet e kandidatit z. {...}, konstatohet se ai nuk disponon dokument që të provojë **“mbajtjen e gradës shkencore në drejtësi”**, të përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

IV. KONKLZIONI

1. Sa më lart, **Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidati {...}, nuk plotëson kushtin e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, atë të “mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”**, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, **prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.**

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret **nuk është e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këtë kandidat**, përse kohë, sipas ligjit, mosplotësimi edhe i një kushti të vetëm kandidimi passjell skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pika 1 dhe 5,

të nenit 49 në lidhje me pikat 4, shkronja “c” dhe 6, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “a”, të nenit 86 dhe nenet 97, 98 dhe 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “e”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I

1. Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, Vendimin nr.109, datë 09.07.2019 dhe Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Tiranë, më datë 11.09.2019

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR